

Përgjegje ndaj reagimit të familjes Pruthi kundër emisionit “Falsifikimi i Trashëgimisë” të transmetuar në “Drejtësia në Kosovë”

Më 12 shkurt 2013 emisioni Drejtësia në Kosovë ka pranuar një reagim nga Gazmend Pruthi, i cili në emër të vetin dhe të Blerim e Fitore Pruthit reagon në lidhje me transmetimin e emisionit Drejtësia në Kosovë me temë “Falsifikimi i Trashëgimisë”, transmetuar më 10 shkurt 2013 në Televizionin e Kosovës.

Na lejoni t’ua kujtojmë se emisioni i transmetuar në 10 shkurt të vitit 2013 ka filluar të hulumtohet nga ekipi jonë që nga korriku i vitit 2012. Që nga atëherë, pasi jemi kontaktuar nga familjari juaj, poashtu pjesëtar i familjes Pruthi, por i cili e ka konsideruar veten të dëmtuar, ne ju kemi kontaktuar dhe kemi kërkuar që ju të prononcoheni. Ju vet, në vazhdimësi, e keni refuzuar këtë mundësi.

Në ndërkohë, ne kemi kontaktuar edhe institucionet siç janë gjykatat që janë kompetente për këtë rast, gjykata komunale në Prishtinë, gjykata komunale në Graçanicë dhe gjykatësit e prokurorët që janë marrë me këtë rast.

Këto burime konifirmojnë se ju keni bërë shkelje të ligjit, duke përpiluar aktin e vdekjes së Faik Pruthit duke mos i deklaruar të gjithë trashëgimtarët ligjorë dhe duke e përjashtuar vëllaun tuaj Shkelzen Pruthi. Këtë shkelje, ju vet nuk e mohoni në letrën tuaj.

Kjo shkelje ligjore e juaja është vërtetuar nga gjykatësja Makifete Saliuka, nga gjyqtari Nenad Llaziq, por edhe nga prokurori Ilaz Beqiri i cili pasi ka shqyrtuar të gjitha dëshmitë, ka vendosur të ngrejë aktakuzë kundër jush, përkatësisht kundër Fitore, Blerim dhe Gazmend Pruthit me dyshimin se keni kryer veprën penale të legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë. Aktakuza është dorëzuar në gjykatë më 2 gusht 2012 dhe Drejtësia në Kosovë posedon një kopje të aktakuzës.

Në reagimin ndaj emisionit tonë, Gazmend Pruthi, në emër të tij dhe Blerim e Fitore Pruthit e akuzon ekipin e Drejtësia në Kosovë se kinse është paguar dhe kinse është dirigjuar për të thënë të pavërteta për familjen Pruthi. Si është e mundur që këto “të pavërteta” qenkan vërtetuar nga gjykata?

Reagimi juaj gjithashtu kërcënon emisionin Drejtësia në Kosovë, mes tjerash duke deklaruar se ky emision ka bërë “gabim të rëndë që e keni përfol dhe vjellë të pavërteta për Familjen Pruthi”. Si është mundur që është “gabim i rëndë” për një media hulumtuese të ekspozojë faktin që, sipas gjykatës, ju jeni ata që akuzoheni të keni bërë “gabim” ngase akuzoheni të keni kryer veprën penale duke përpiluar aktin e vdekjes me trashëgimtarë të mangët?

Në fakt duket që emisioni ka ekspozuar gabimet e të pavërtetat që ju ua keni servuar gjykatës, e tash kur jeni ekspozuar në media për këtë punë, ju keni zgjedhur të reagoni ndaj emisionit e jo lidhur me çështjen që ne dhe gjykatat kanë ngritur lidhur me rastin tuaj.

Ne poashtu posedojmë dëshmi se sa herë kemi tentuar të marrim prononcim nga ju, duke e kryer në plotësi detyrën tonë të raportimit të paanshëm dhe ofrimit të hapësirës

së njëjtë të gjitha palëve të involvuara. Keni qenë ju vet ata të cilët keni refuzuar të prononcoheni, përkundër insistimeve tona, duke thënë që nuk keni kohë.

Çuditërisht, ju keni gjetur kohë vetëm pas transmetimit të emisionit, që të shkruani letër. Por, në këtë letër, ju nuk i përgënjeshtroi të gjeturat tona. Ju vetëm na akuzoni për gazetari joprofesionale dhe i shpjegoni në hollësi arsyet të cilat juve ju kanë shtyrë që t'i kryeni shkeljet ligjore për të cilat tani ju akuzon prokuroria e Kosovës.

Fundja, në letrën tuaj, ju nuk i mohoni shkeljet ligjore për të cilat sot ju akuzon prokuroria e Kosovës, e për të cilat ne kemi raportuar në pajtim me standardet më të larta të gazetarisë.

Përfundimisht, unë vet si producent, tri ditë para transmetimit të emisionit, kam kontaktuar me Blerim Pruthin, i cili përsëri ka kërkuar nga unë që të mos merremi me këtë temë dhe decidivisht më ka siguruar se as ai, e as Gazmend e as Fitore Pruthi nuk do të prononcohen për emisionin tonë.

Më lejoni t'ua kujtoj se emisioni Drejtësia në Kosovë shërben si shembull i gazetarisë profesionale dhe të paanshme jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon.

Këtë më së miri e tregon shikueshmëria dhe besimi i publikut në emisionin tonë, por edhe numri i çmimeve dhe shpërblimeve me të cilat emisionet dhe gazetarët tonë janë dekoruar dhe vazhdojnë të dekorohen, mu për shkak të profesionalizimit dhe paanshmërisë sonë në raportim.

Më lejoni poashtu t'ua kujtoj se secili nga emisionet dhe raportet tona janë të bazuara në fakte dhe në disa burime të ndryshme e të pavarura. Secili nga emisionet tona kalon nëpër disa nivele filtrash, për t'u siguruar se plotësohen standardet më të larta të raportimit dhe gazetarisë profesionale.

Për këtë arsye, ne nuk ndiejmë obligim që të transmetojmë reagimin tuaj në emisionin tonë. Për hir të mirësjelljes, ajo që do të bëjmë është se do ta publikojmë letrën tuaj në internet faqen zyrtare të emisionit Drejtësia në Kosovë, së bashku me përgjegjen tonë.

Për më shumë, ju inkurajojmë që të vazhdoni t'i shiqoni emisionet tona ngase, përpos tjerash, ne do të vazhdojmë të monitorojmë veprimet ligjore që do të ndërmerren nga autoritetet publike lidhur me këtë rast.

Sinqerisht,
Faik Ispahiu
Drejtësia në Kosovë